



NEWSLETTER

Qershor 2024

Nr.6

Arsimimi mediatik tek nxënësit e vitit të parë dhe të dytë të arsimit të mesëm në fokus të takimit të dytë publik të ASHMA-së



Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele më 27 qershor 2024, ka mbajtur takimin e dytë publik për këtë vit, në të cilën u promovua Hulumtimi i arsimimit mediatik tek nxënësit e vitit të parë dhe të dytë të arsimit të mesëm, e disponueshme në [macedonisht, anglisht dhe gjuhën shqipe](#). Qëllimi i hulumtimit ishte të bënte një vlerësim të gjendjes tek të rinjtë në këtë fushë, më saktë të hulumtonte mendimet, zakonet dhe perceptimin e nxënësve me fokus në aftësitë e tyre për të kuptuar mesazhet mediatike që transmetohen çdo ditë përmes mediave të ndryshme dhe kanalet e informacionit.

Siç theksoi drejtori Dr. Zoran Trajčevski, me këtë hulumtim ASHMA ofron të dhëna relevante që mund të përdoren në të gjitha reformat e mëvonshme, sepse është bërë mbi një mostër reprezentative të të gjithë nxënësve që vitin e kaluar shkollor janë regjistruar në vitin e parë dhe të dytë të arsimit në shkollat e mesme dhe shkollat profesionale. Për rëndësinë e hulumtimit foli dhe Dejan Dokuzovski nga projekti i USAID për arsimimin mediatik „Të rinjtë mendojnë“ realizuar nga IREKS, Instituti Maqedonas për Media, Instituti për Studime Komunikimi dhe Forumi Rinor Arsimor, i cili theksoi se pret arsimimi mediatik të bëhet pjesë e arsimit të mesëm në vend. Hulumtimi është kryer me 884 të anketuar nga 40 shkolla të mesme në 19 komuna, dhe në të, ndër të tjera, janë analizuar detajisht shfrytëzimi dhe përdorimi i pajisjeve elektronike nga ana e nxënësve, njohja e përmbajtjes dhe të menduarit kritik për informacionet e marra përmes televizionit dhe internetit, rrjete sociale më të përdorura, theksoi Sofija Ristova, nga Agjencia për Rejting e cila për nevojat e ASHMA-së e ka bërë këtë hulumtim.

Në pjesën e dytë të takimit, drejtori Dr. Zoran Trajčevski bëri një pasqyrë të aktiviteteve të realizuara në përputhje me Programin vjetor të punës për tre muajt e fundit.

Analiza e tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me qëllim të dhënies së njohurive mbi gjendjen në industrinë televizive dhe në radio, më 24 qershor 2024, publikoi Analizën e Tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023. Analiza përmban të dhëna për funksionim ekonomik të transmetuesve, gjegjësisht të dhëna për të ardhurat në total dhe për strukturën e të ardhurave, harxhimet në total dhe strukturën e harxhimeve, rezultatin financiar të punës (veprimtarisë) dhe numrin mesatar të të punësuarve në vitin 2023.

Analiza e Tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023 është e disponueshme në këtë [link](#)

Raport i përgatitur për pronësinë e mediave në vitin 2024

Me qëllim, për të rritur transparencën e pronësisë së mediave, pra për t'i ofruar publikut akses të lehtë dhe të drejtpërdrejtë në të dhënat për personat fizik dhe juridik që janë pronar(zotëruar) të mediave, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele më 20 qershor 2024, publikoi [Raportin për pronësinë e mediave në vitin 2024](#). Përveç se që në vazhdimësi i siguron këto të dhëna në regjistra të veçantë në ueb-faqen e saj, Agjencia disa vite përgatit dhe analiza të rregullta vjetore/raporte për pronësinë e medias.

Mbikëqyrja e transmetuesve, ORRPKE dhe medias së shtypit

Transmetuesit

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele sipas detyrës zyrtare ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore mbi punën e TV Gurra nga Kërçova, me qëllim që të konstatohet nëse transmetuesi gjatë një jave realizon së paku 80% të konceptit programor për të cilin i është dhënë leja. Gjatë mbikëqyrjes mbi shërbimin programor të TV Gurra, transmetura në nivel lokal(vendor), në periudhën nga data 3 deri më 9 qershor 2024, është konstatuar shkelje e nenit 67 paragrafi (6) të LSHMAAV, gjegjësisht për mosrealizim i së paku 80% të konceptit programor për të cilin i është dhënë leja për punë.

Në shërbimin e dytë programor të Radio Televizionit të Maqedonisë Shkup – TVM 2, Agjencia ka kryer mbikëqyrje të kontrollit programor për të përcaktuar nëse është vepruar sipas masës së shqiptuar më parë vërejtje publike për mos transmetim ditor 40% të programit të krijuar burimor si vepra audio dhe audiovizuele maqedonase. Me mbikëqyrje është konstatuar se TVM 2 ka vepruar plotësisht sipas aktvendimit për shqiptimin e masës – vërejtje publike.



NEWSLETTER

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative mbi të gjithë transmetuesit që emetonin program televiziv dhe në radio në vitin 2023. Lëndë e mbikëqyrjes ishte detyrimi i transmetuesve deri më 31 mars 2024, drejtua Agjencisë të dorëzojn raport për realizimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim televiziv dhe radio, në veçanti për realizimin e konceptit programor. Nga mbikëqyrja u konstatua se këtë detyrim ligjor nuk e ka plotësuar vetëm RA PRO-FM nga Gostivari.

Ndaj të gjithë transmetuesve që emetojnë program në radio, është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative për të përcaktuar nëse dikush ka ndryshuar strukturën e pronisë, pa njoftuar paraprakisht Agjencinë. Nga mbikëqyrja u rezultua se asnjë transmetues nuk ka kryer ndryshim në strukturën e pronisë pa e njoftuar paraprakisht Agjencinë dhe pa u miratuar nga Agjencia.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrativ dhe programor mbi TV Gurra nga Kërçova për të përcaktuar nëse transmetuesi ka vepruar sipas masave të shqiptuara vërejtje publike, për shkak të mos respektimit të disa detyrimeve nga LSHMAAV dhe Ligjit për Media. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se transmetuesi ka vazhduar të mos ofrojë informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion shfrytëzuesve dhe të mos transmeton së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, e as gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, në periudhën nga ora 7:00 deri në ora 19:00. Një pjesë të kontrollit mbikëqyrës që ka të bëjë me rregullat për mbrojtjen e audiencës së mitur (fëmijëve), detyrimin për publikim impresiu dhe kushteve për reklamim dhe teleshopping, në fakt nuk kanë mundur të realizohen, sepse transmetuesit në ditën e mbikëqyrjes, përveç spoteve muzikore nuk ka transmetuar asnjë lloj tjetër programi me angazhim gazetaresk dhe editorial, dhe prej andej Agjencia sipas detyrës zyrtare do të kryejë mbikëqyrje të jashtëzakonshme njëjavore mbi transmetuesin.

ORRPKE

Ndaj operatorëve Kablekall dhe Infell-Ktv është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore për të përcaktuar nëse operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik i transmetojnë shërbimet programore nga Pakoja Pink, për të cilën nuk është e rregulluar e drejta e autorit në pajtim me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Me mbikëqyrje është konstatuar se operatorët nuk i transmetojnë shërbimet programore nga Pakoja Pink.

Media e shkruar

Mbi botuesit e medias së shkruar KAPITAL MEDIA GROUP botues në „Kapital“, JENI BALKAN botues në „Bahçe“, EURO-MAK KOMPANI botues në „Ekonomia dhe biznesi“, KOLOR MEDIA PLUS botues në „Bukuria dhe shëndeti“, BIRO PRES botues në „Porta 3“, VIZIONI M botues në „Shenja“, PABLIK botues i „Lice v lice“ dhe KLIKER MARKETING botues i „InStore“, REPRO PRINT botues i „Nova Makedonija“, SLOBODEN PEÇAT botues i „Sloboden peçat, VEÇER PRES botues i „Veçer“, KOHA PRODUKSION botues në „Koha“, MEDIA PLUS FOKUS botues në „Fokus“, MEDIJA PRES BM botues në „Bitollski vesnik“, ATV MEDIA KOMPANI botues i „Lajm“, MEDIUM BOJA 43 botues në „Shtipski gllas“, EHO MEDIA GRUPA botues në „Skopsko Eho“ dhe „Makedonsko Eho“, ZENIT PRES PLUS botues i „Zenit“ dhe NARODEN LEKAR botues në „Naroden lekar, Agjencia ka realizuar mbikëqyrje të rregullt administrative për detyrimin për publikim impresium, të dhëna për selinë, shtypshkronjën, datën e botimit ose ribotimit dhe numrin e kopjeve të shtypura, detyrime nga Ligji për Media. Mbikëqyrja rezultoi se mediat kanë përbushur detyrimet ligjore.

Masat e shqiptuara

Këshilli i Agjencisë në seancën e 25-të mbajtur më 31 majj 2024, në bazë të konstatimeve të kontroleve të rregullta administrative, miratoi dy Aktvendime për shqiptimin e masës vërejtje publike për radio Galaksi – 2002 nga Kavadari dhe radio Pro-FM nga Gostivari, për shkelje të nenit 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media, gjegjësisht për mosdorëzim të të dhënave për strukturën e pronisë, redaktorin përgjegjës/redaktorët, burimet e financimit në vitin 2023, të ardhurat dhe shpenzimet në total të realizuara nga ofrimi i aktiviteteve në vitin 2023 dhe për dëgjueshmërinë (audiencën) mesatare në vitin 2023.

